

URDHËR
Nr. 520, datë 9.10.2025

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR JOPUBLIK, KOPSHTI “KATËR STINËT”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 7, të nenit 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të urdhrit nr. 497, datë 29.9.2025, të ministrit të Arsimit, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit, znj. Orjana Osmani, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”, e subjektit juridik “4 Stinë” sh.p.k, i licencuar me urdhrin nr. 352, datë 3.12.2001, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, me kërkesën e tij datë 25.9.2025

2. Institucioni arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”, ka për detyrë:

a) Të vendosë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër.

b) Të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

c) Të kthejë pagesat e kryera nga prindi/përfaqësuesi ligjor i nxënësit për pjesën e papërfunduar të arsimit parashkollor, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur nëse ka.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Tiranë, ka për detyrë:

a) Të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”.

b) Të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik.

c) Të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, i ndryshuar, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik kopshti “Katër Stinë”.

4. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Tiranë të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Në rast të moszbatimit të detyrimeve nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik, kopshti “Katër Stinë”, të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të marrë të gjitha masat, sipas legjislacionit në fuqi.

6. Urdhri nr. 352, datë 3.12.2001, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës, “Për dhënien e lejes së funksionimit të institucionit arsimor jopublik”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Arsimin dhe Sportin, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Tiranë, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor parauniversitar jopublik kopshti “Katër Stinë”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSMINISTËR I ARSIMIT

Orjana Osmani